



100 Vjet Pavarësi



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 2474 / Prot
11

Tiranë, me 21. 11, 2012

Lënda: Urdhër për Kontrolluesin "Gazeta Shqip", Tiranë.

URDHER
Nr. 07, datë 21/11/2012

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr.225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të Kontrolluesit "Gazeta Shqip", Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të urdhrit nr.125 datë 20/07/2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar inspektimin administrativ pranë kontrolluesit "Gazeta Shqip", Tiranë, me objekt:

- Ligjshmëria e përpunimit të dhënave personale, në bazë të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe Udhëzimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr.9, datë 15.09.2009, "Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive", përsa i përket publikimeve të "Gazeta Shqip", në lajmet me titull:

1-"Sherri, në ndjekje penale pedagogu dhe studenti", publikuar në datë 26.04.2010;

2-"Shkolla e policisë, shpallen 143 kandidatët e parë fitues", publikuar në datë 20.04.2009;

3-"Shkolla e policisë, të gjitha emrat dhe kodet e aplikantëve", publikuar në datë 20.04.2009;

4-“Shkolla e policisë, shpallet renditja përfundimtare”, publikuar në datë 27.05.2009.

Në brendësi të këtyre lajmeve përmendet shtetasi _____, ankesa e të cilit, vuri në lëvizje këtë inspektim administrativ të Komisionerit për Mbrojtje e të dhënave Personale.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ, të datës 03.08.2012, prej nga shihet qartë se, përfaqësuesi i kontrolluesit “Gazeta Shqip”, Tiranë z. _____, me cilësinë e kryeredaktorit të kësaj të përditshmeje, shpreh gatishmërinë të fshijë nga arkiva elektronike e kësaj gazete, vetëm lajmin, “Shërri, në ndjekje penale pedagoгу dhe studenti”, publikuar në datë 26.04.2010.

Pasi ju bë e ditur, ankuesit _____, se kjo e përditshme e ka parë të arsyeshme që prej listave të publikuara, të mos hiet emri i tij, ka reaguuar duke përsëritur ankesën e tij, pranë Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale. Grupi i inspektimit, ka kontaktuar sërish me përfaqësuesin e kontrolluesit, “Gazeta Shqip”, Tiranë, por edhe pse i është bërë i qartë se, qëllimi për të cilin këto lista janë publikuar, ka përfunduar, ndaj këto lista duhen fshirë, ky kontrollues nuk ka marrë masat për fshirjen e emrit të ankuesit _____, si subjekt i të dhënave personale.

Gjatë takimeve të herëpashershme, kontrolluesit ju bë me dije, se në bazë të Udhëzimit nr.9, datë 15.09.20104, “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive” dhe konkretisht paragrafi 4, shprehet: “Ushtrimi i së drejtës së lirisë së shprehjes nuk është i pakufizuar sepse kërkohet të bëhet brenda kontureve të kërkesave të parashikuara në nenet 15, 17, 36, 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë pasi të drejtat themelore të njeriut janë të padhumeshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik dhe se ato mund të kufizohen vetëm me ligj.”

Kontrolluesi “Gazeta Shqip”, në rastin e mosfshirjes së emrit të ankuesit _____ nga listat e publikuara prej saj, ka shkelur nenin 5, paragrafi 1, gërma “c” të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, sipas të cilit:

“1- Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:

c) në rraftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 27-30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

U R D H Ë R O J

1. Në zbatim të nenit 5, nenit 30 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Nr.9, datë 15.09.2009 “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive” kontrolluesi, Gazeta Shqiptare, duhet të bëjë fshirjen e të dhënave identifikuese të shtetasit _____ në të gjitha listat, objekt i publikim tuaj, ku ai figuron si kandidat fitues në Shkollën e Akademisë së Rendit në lidhje me lajmet e cituara në pjesën arësytuese të këtij Urdhëri.

2. Kryerja e këtij detyrimi të rëndësishëm ligjor të kryhet brenda një afati kohor prej 5

KOMISIONERI
Flora ÇABEJ (POGAÇE)

Në mungesë dhe me porosi

